





Komuna e Deçanit

Pozita Gjeografike e Komunës së Deçanit në Kosovë



Të dhënat e përgjithshme

- Deçani apo Ulëza e dikurshme është vend i banuar, që nga kohërat e lashta.
- Shënimet e para të shkruara në të cilat përmendet Deçani dhe disa fshatra të tij, janë mjaft të vjetra, ato datojnë që nga gjysma e parë e shek. XIV. Këto dokumente quhen "krisobula".
- Komuna e Deçanit formohet si komunë në vitin 1963.
- Vendbanimet në të kaluarën kryesisht kanë qenë fshatrat me kulla.
- Karakteristikë për rrethinat e Deçanit janë edhe vendbanimet që ndërtohen gjatë stinës së verës, në bjeshkët e këtyre anëve të ashtuquajtur tëbanat (stane).

Pozita gjeografike

- Komuna e Deçanit ka një pozitë mjaft të mirë gjeografike. Ndodhet në pjesën perëndimore të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit. Gjendet pothuajse në qendër të Ballkanit, në vijën ajrore është larg nga Deti Adriatik 90 km, kurse 220 km larg nga Deti Egje.

Komuna e Deçanit ka një sipërfaqe prej 288.40 km² ose 28.840 ha nga e cila janë:

8940.4 ha tokë pjellore

14420 ha pyje

5479.6 ha kullosa

Reliefi

- Lartësia mbidetare varion nga 412 lmd, fshati Maznik deri 2530 m lartësi mbi detare në Marjash, që d.m.th. në saje të krijimit të reliefit Komuna e Deçanit ndahet në dy pjesë:
-
- *në ultësi që është pjesa e rrafshit të Dukagjinit*
- *dhe në lartësinë që përfshin masivin e Bjeshkëve të Nëmura (Alpet Shqiptare)*
- Bjeshkët e Nëmuna apo Alpet Shqiptare shtrihen në pjesën perëndimore të komunës së Deçanit.
- Lartësia e Bjeshkëve të Nëmuna pak ndryshojnë nga lartësia e vargmaleve alpike. Këto janë pjesët më të larta dhe më shkëmbore të vargmaleve të siujdhesës Ballkanike, me ç'rast shkëmbinjtë e bardhë dhe të dhëmbëzuar formojnë pamje imponante.

Popullsia

- Sipas regjistrimit të vitit 2011 rezultate preliminare, numri i banorëve në komunë është **40168** ndërsa i ekonomive familjare 6141. Struktura gjinore është:
- **Meshkuj-----20088 banorë**
- **Femra-----20080 banorë**
-
- Komuna e Deçanit ka 6141 ekonomi familjare, ku madhësia e familjes është 6 banorë për një amvisëri.
- Pas lufte ekziston një migrim i banorëve nga fshati në qendrën urbane dhe jashtë shtetit.
- **Vetëm në qytet jetojnë 3794 banor, prej të cilëve 1885-meshkuj, ndërsa 1909 janë femra.**

Komuna e Deçanit ka mundësi të mira të lidhjes me regjionin

- Deçani ka mundësi të mira për lidhje me qendrat e Kosovës,po ashtu ka kushte të volitshme për zhvillimin e turizmit ndërkufitar me Shqipërinë dhe me Malin e Zi.

K l i m a

- Në shtrirjen gjeografike të bjeshkëve të Deçanit mbizotëron klimë e butë me ndikim mesdhetar e karakterizuar me elementët kryesorë klimatik të Bjeshkëve të Nëmura si : rrezatim të mjaftueshëm të diellit dhe të reshura atmosferike gjatë gjithë stinëve të vitit.
- Elementet kryesore klimatike që i përkasin komunës sonë janë: moti i kthjelltë, lartësia e lartë mbidetare e kompleksit të bjeshkëve, temperatura të freskëta gjatë verës dhe mjaft të ftohta gjatë dimrit, reshjet atmosferike (dëborë) të bollshme, të ujërave në sasi të mjaftueshme.

Trashëgimia natyrore

- Rajoni turistik i Bjeshkëve të Deçanit , është hapësirë kapitale e trashëgimisë natyrore, për zhvillimin e turizmit.
- Bukuritë natyrore dhe vlerat e këtij territori e posaçërisht Gryka e Deçanit kanë vend të rëndësishëm në vlerësimet e vlerave të peizazhit, dhe bukurive natyrore specifike me florë dhe faunë. Vlerë të mëdha këtij territori i shtonë edhe Gryka e Deçanit më Kanjonin e Lumbardhit të Deçanit si dhe Gryka e Lloqanit me Lumëbardhin e Lloqanit, vlera që krijojnë mundësi të jashtëzakonshme për erskurzime të ndryshme, vizita nga turistët e huaj si dhe ata vendas.
- **Rezervatet natyrore si:** Kozhnjerit, Maja Ropsit, Bjeshka e Prejlepit, Zona e Rëndësisë së Posaçme (viti i shpalljes 2005), si dhe pjese të tjera të Bjeshkëve të Nëmura.

Kapacitetet e mundshme sportive

- Mundësia e ngritjes së qendrave për sporte të bardha sipas studimeve ndërkombëtare të bëra në vitet e 70-ta tregojnë se, në këtë rajon turistik, mund të ndërtohen 4 qendra ,për zhvillimin e turizmit dimëror-sportiv në Bjeshkët e Deçanit.

Vendet me mundësi për ngritjen e qendrave turistike :

Qendrat kryesore

Maja e Kurvallës
Bjeshka e Belegut
Maja e Strelcit



Pamje nga gara e skijimit “Kupa e Gjeravicës” /Mars/2004



BURIMET UJORE

- Teritori i Komunës së Deçanit, shtrihet në pellgun e dy lumenjve, të cilët burojnë në masivin e Bjeshkëve të Nëmura, të cilët kanë burime të shumta të ujit. Lumenjtë që burojnë dhe përshkojnë territorin e komunës janë:
- **Lumëbardhi i Deçanit**
- **Lumbardhi i Lloqanit**
- Teritorin e Komunës së Deçanit e përshkojnë edhe një numër i konsiderueshëm i prrojeve dhe prrockave si: Përroi Durakut i Strellcit, Përroi i Behovcit, Prrojet e Vokshit, Përroi i Glllogjanit, Përroi i Lëbushës, dhe Përroi i Ratishit.

Liçenjet

- Në lartësinë e bjeshkëve ekziston një numër madh i liqenjeve me origjinë glaciale të njohur në gjuhën popullore si “syte e maleve”. Këta liqej janë burimet kryesore të vlerave mjedisore, turistike dhe ekonomike për komunën tonë. Liqejt natyror që gjenden në masivin e Bjeshkëve të Nëmuna paraqesin habitat për interes të veçantë për zhvillimin e turizmit, por nuk janë aq shumë të hulumtuar.
- Më të njohurit janë :
- Liçeni akumulues i Radoniqit,
- Liçeni i pafund
- Liçeni leqe-leqe
- Liçeni i Zi
- Të gjithë këta liqej ndodhën në lartësit mbidetare nga 2000 – 2500 m.

Uji mineral

- Burimi i njohur i ujit mineral (të thartë) është afër Manastirit të Deçanit



Deçan / shtatori / 2012


Flora dhe Fauna

- **Flora**-Në Bjeshkët e Nemuna ,sipas shumë studimëve janë mbi 1500 lloje bimore
- Nga këto:-33 lloje janë endemike dhe subendemike .
- **Fauna**-E Bjeshkëve të Nemura përbëhet prej:8-lloje të peshqeve,13-lloje të ujëtokësorëve,10-lloje rrëshqitës,200-lloje shpendësh,36-lloje gjitarësh,129-lloje fluturash.

Flora dhe Fauna



Flora dhe Fauna



Kushte te mira per bujqësi



Deçan / shtatori / 2012

Kushte të mira për bujqësi



Deçan / shtator / 2012

Zonat dhe lokalitetet turistike te Deçanit

1. Zona e Deçanit me rrethinë

- lokaliteti i luginës së Lumbardhit
- lokaliteti i Radoniqit
- lokaliteti i Podit të Geshtenjave

Zonat turistike të Deçanit

- **2. Zona e Grykës së Deçanit:**
 - lokaliteti i Pishave të Deçanit
 - lokaliteti i Bellesë dhe Pleqës
 - lokaliteti i Kozhnjerit
 - lokaliteti lugina e Lumbardhit
 - lokaliteti Bjeshka e Belegut,
 - lokaliteti bjeshka e Prejlepit
 - lokaliteti bjeshka e Roshkodolit
 - lokaliteti bjeshka e Milishevcit
 - lokaliteti bjeshka e Zllonopojës

Zonat turistike te Deçanit

- lokaliteti Bjeshka e Baballoqit)
- lokaliteti Bjeshka Zalli i Rupës
- lokaliteti Bjeshka e Korijs e Carrabregut
- lokaliteti Bjeshka e Dobroshit

Zonat dhe lokalitetet turistike te Deçanit

3. Zona e bjeshkëve të Strelcit:

- lokaliteti Gryka e Behovcit
- lokaliteti Bjeshka e Gllogjanit

Zona dhe lokalitetet turistike të Deçanit

4. Zona e Grykës së Lloqanit :

- lokaliteti Bjeshka e Madhe (Bjeshka e
- Deçanit dhe e Carrabregut)
- lokaliteti Kurvalla

Trashigimia kulturore

- Territori i Deçanit është i pasur me monumente kulturore, historike dhe arkeologjike. Vendet më interes të madhe janë, lokalitet arkeologjike parahistorike në Vranoc të Vogël, Gllogjan, Strellc i Epërm, Rastovicë, Irzniq, dhe Baballoq, monumentet myslimane, kullat, monumentet kristiane si dhe mullinjët.
- Ndër kullat më të njohura janë kulla e Osdautajve dhe ajo e Kuklecëve në kompleksin kullave në Isniq, kulla e Demukajve dhe Mushkolajve në Deçan, Kulla e Mazrekajve dhe Binakajve në Kompleksin e Kullave në Dranoc, Kulla e Ramë Shabanit në Prapaqan, Kulla e Ali (Demë) Gecit në LLukë të Ulët, Kompleksi i Qelisë si dhe një numër i kullave në pjesët e tjera të Komunës tonë histori/sh_i_tahir_geci.htm dt.22/05/2012

Trashigimia kulturore



Deçan / shtatori / 2012



Deçan / shtator / 2012

Manastiri I Deçanit - UNESCO



Deçan / shtatorl / 2012

Trashigimia kulturore



Deçan / shtator / 2012

Hotelet e reja turistike



Deçan / shtatori / 2012



Deçan / shtatori / 2012